



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 1778, datë 20.02.2012

Për

“Miratimin e tarifave të Albtelecom sh.a për ofrimin e shërbimeve të Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.02.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e tarifave të Albtelecom sh.a për shërbimet e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 43, 57 dhe 59 ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.
3. Rregullorja Nr.19 datë 14.06.2010 për “ Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1300, datë 14.06.2010, i ndryshuar (*Rregullorja e Akses/Interkoneksionit*).

4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1348, datë 26.07.2010, “Percaktimin e sipërmarresit Albtelecom Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit te telefonise fikse”, i ndryshuar.
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1650 dt. 29.06.2011 “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit” i ndryshuar me VKD nr. 1692 dt. 19.09.2011 për “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom në lidhje me aktin administrativ, vendimit nr. 1650 dt. 29.06.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”.
6. Rregullore Nr. 23 datë 29.06.2011 “Për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit”(rregullore për Z(P)B), miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1650 dt. 29.06.2011, i ndryshuar.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albtelecom me Nr.5444 Prot., date 1.12.2012 (AKEP: Nr.1834 Prot., date 2.12.2012);
2. Projektvendim i KD të AKEP pwr ”Miratimin e tarifave Albtelecom sh.a për shërbimet e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”;
3. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**), si dhe, nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

1. AKEP me VKD nr.1348 date 26.07.2010 (i amenduar) ka vendosur per Albtelcom detyrimin per ofrimin e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes se Bartësit tw thirrjeve;
2. AKEP me VKD nr. 1650 dt. 29.06.2011 “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit” i ndryshuar me VKD nr. 1692 dt. 19.09.2011 për “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom në lidhje me aktin administrativ, vendimit nr. 1650 dt. 29.06.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentacionit për implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”, ka miratuar Rregullore dhe Udhezimi per Z(P)B.
3. Albtelecom me shkresen Nr.5444 Prot., date 1.12.2012 (AKEP: Nr.1834 Prot., date 2.12.2012), ka depozituar amendime të RIO për përfshirjen e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit, si dhe i ka publikuar këto amendime në faqen e vet të Internetit. Amendimet konsistojnë në shtimin e përkufizimeve,

bazës juridike, çështjeve teknike dhe pagesa për Z(P)B që operatorët bartës duhet ti paguajnë Albtelcom për këtë shërbim.

4. Në lidhje me pagesat fikse për shërbimin e Z(P)B, Albtelcom ka propozuar:

Në Aneks 4 “Tarifat e Shërbimeve” shtohet seksioni I.5 “Pagesat në lidhje me Z(P)B”

I.5 Pagesat e operatorit për Albtelcom në lidhje me Z(P)B”

- 1. Tarifë për implementimin e prefiksit të zgjedhjes së bartësit (ZB).***
1,810,000 Lek (vetëm njëherë)
 - 2. Pagesë mujore nga ana e operatorit duke filluar që nga data kur është bërë transaksioni i parë për të mbuluar koston e menaxhimit “live” në vazhdimsi të këtij produkti nga ana e operatorit të aksesit.***
278,000 Lek/muaj
 - 3. Pagesa e operatorit për administrimin e kërkesave nga Albtelcom, (aktivizimin/ndryshim/anullimin/pezullimin) e Z(P)B për cdo pajtimtar, për të bërë konfigurimet përkatëse në sistemin Albtelcom që të mundësojë për cdo pajtimtar për të cilin është kërkuar (aktivizimi/ndryshimi/anullimi/pezullimi) e Z(P)B.***
100 Lek/për kërkesë
 - 4. Tarifë për implementimin e Z(P)B për cdo linjë telefonike, kjo tarifë paguhet vetëm njëherë nga bartësi i thirrjeve për cdo pajtimtar***
690 Lek/pajtimtar
 - 5. Pagesë për implementimin e prefiksit për PB e shprehur në tarifë për të gjitha centralet***
1,810,000 lek
 - 6. Pagesë për minute (surcharge per minute) për rikuperimin nga kostoja e shkaktuar rrjetit për të mundësuar Z(P)B. Kjo pagesë do të vazhdojë për një periudhë prej 5 vjetësh (e ndryshueshme) deri sa të rikuperohen kostot e rrjetit***
0.5 lek/min
5. Në lidhje me pagesat e mësipërme të propozuara nga Albtelcom, AKEP në konsultimin publik për miratimin e Rregullores dhe Udhëzimit për Z(P)B ka trajtuar çështjen e pagesave për Z(P)B, duke theksuar:

Tarifimi për origjinimin e thirrjeve nga Albtelecom për bartësit e thirrjeve do të kryhet në nivel të njëjtë me tarifatat respektive në fuqi të terminimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom. Nderkohe procesi i Z(P)B gjeneron kosto fikse për operatorin e rrjetit (Albtelcom) të nevojshme për programimin për implementimin e ZB dhe të PB, si dhe kosto për administrimin e kërkesave. Nga të dhëna në oferta referencë të operatoreve inkumbent vihet re se tarifa të tilla përfshijnë:

- *Tarife për implementimin e kodit të ZB (paguhet një here dhe në bazë të numrit të centraleve ku implementohet);*
- *Tarife për implementimin e PB: paguhet një here dhe mund të jetë për implementimin në të gjithë centrat ose të shprehur në tarife për central.*
- *Tarife për implementimin e PB për çdo linjë telefonike: kjo tarifë paguhet një here nga bartësi i thirrjeve për çdo pajtimtar që përdor PB.*

Per keto tarifa, AKEP nuk ka mundur të gjejë tarifa referencë mesatare. Niveli i tarifave të mesiperme në disa RIO duket se ka diferencë të mëdha, dhe për këtë arsye AKEP mirepret komente të paleve të interesuara (sidomos Albtelecom) në lidhje me mënyrën e përcaktimit të këtyre tarifave dhe nivele të mundshme për keto tarifa.

Ne përfundim të konsultimit publik AKEP është shprehur:

Aplikimi i këtyre tarifave (përveç tarifave të origjinimit) dhe niveli i tyre, do të jenë objekt i shqyrtimit dhe miratimit të AKEP në vendim-marrjen për miratimin e propozimit të Albtelecom për amendimet e RIO-s së Albtelecom për përfshirjen e shërbimit të Z(P)B në këtë RIO.

6. AKEP me shkresën nr.1884/1 Prot, datë 23.01.2012 i ka kërkuar Albtelecom që bazuar në pikën 3 të nenit 43 si dhe në pikën 1 të nenit 59 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Albtelecom të provojë që tarifatat e propozura në seksionin e cituar më lart janë rrjedhojë e kosto efiçente, duke mundur një normë fitimi të arsyeshme. Informacioni të depozitohet në AKEP brenda datës 1.02.2012.
7. Albtelecom me shkresën nr.393/1 prot., datë 1.02.2012, ka dërguar informacion duke shpjeguar se:
 - a. Albtelecom në përcaktimin e tarifave të propozuara i është referuar tarifave respektive të British Telecom (duke dhënë edhe referencën përkthënë), si një ndër referencat më të mira në botë për implementimin e detyrimeve rregullatore, si dhe për shkak të ngjashmerisë që ka rrjeti i BT me atë të Albtelecom;
 - b. Gjithashtu Albtelecom thekson se në propozimin e bërë kanë marrë në konsideratë tarifatat e aplikuar në vendet fqinjë, dhe nga krahasimi rezultojnë se tarifatat e propozuara të Albtelecom janë më të lira se ato të vendeve të rajonit. Albtelecom ka dhënë edhe vlerat e tarifave të aplikuar në vendet e rajonit për Z(P)B, si Kroacia, Mali i Zi dhe Turqia të cilat për pagesën fikse (paguhet vetëm njëherë) të implementimit të ZPB variojnë nga 27.5

mijë Euro në Mal të Zi në rreth 70 mijë Euro në Kroaci (propozimi i Albtelcom për këytë tarifë është 1.8 milion lek apo rreth 15 mijë Euro).

8. Albtelcom në përgjigjen e tij ka dhënë referenca dhe krahasime me vende të tjera por nuk ka bërë justifikim në kosto të tarifave të propozuara, dhe sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 59 të ligjit 9918, atëherë tarifat e propozuara nga Albtelcom konsiderohen nga AKEP si jo të orientuara në kosto.
9. Në bazë gërmave “a”, “b” dhe “c, pika 2 e nenit 57 të Ligjit 9918, AKEP ka të drejtë që në regullimin e tarifave të vlerësojë (midis të tjerave) edhe të dhënat më të fundit për:
 - praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;
 - tarifat mesatare të vendeve të BE-së;
 - tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.
10. Duke analizuar tarifat në disa oferta referencë të operatorëve inkumbent në vendet e BE vihet re se ka varianca të mëdha (e konstatuar që në konsultimin publik):
 - Ka vende që nuk aplikojnë këto pagesa fikse p.sh Irlanda (0.83 euro për kërkesë) dhe Rumania kane vetëm pagesa fikse simbolike për administrimin e kerkesave per PB (zëri 3 në pikën 4 më sipër nga propozimi i Albtelcom);
 - Ndër vendet e evidentuara që aplikojnë pagesa për implementim të kodit Z(P)B, ka varianca të mëdha sic shikohet nga tabela më poshtë, nga rreth 1200 euro ne 19 mijë euro, si pagese fikse per implementimin e kodit PB në të gjitha centralet.

Tabela 1: Tarifat fikse me shumicë të Implementimit të Zgjedhjes/Parazgjedhjes së Bartesit në vende të BR (Euro pa TVSH)

| | Belgjika (Belgacom) | Zvicra (Swisscom) | Malta (Maltacom) | Angli (BT) |
|---|--|-----------------------------------|----------------------------------|-----------------------|
| Implementimi i kodit të ZPB (pagese fikse vetem njehere) | 19000 | 1912 | 1165 | 14433 |
| Pagese në muaj | | | | 2459 |
| Pagesa per pajtimtar/kerkesë | 4.65 (14.95 raste te vecanta) | | 11.65 | |

Burimi: RIO e operatorëve inkumbent fikse në vendet respektive

- BT ka aplikuar edhe një tarifë ekstra për cdo thirrje me PB, që paguhet nga operatori përveç tarifave të origjinimit;
- Për sa i përket BT, arsyeja kryesore e vendosjes së pagesave fikse dhe një tarife ekstra për thirrje (zëri 6 nga propozimi i Albtelecom) të miratuara nga OFTEL ka qënë se rrjeti i BT ka qënë (konsideruar) i ndryshëm nga ato të vendeve të BE, duke kërkuar shumë më tepër investime shtesë për implementimin e PB permanente nga BT.

11. Duke analizuar tarifat në disa oferta referencë të operatorëve inkumbent në vendet e rajonit si Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Turqia vihet re në të katër vendet aplikohen tarifa për implementimin e Z(P)B. Disa prej tarifave më kryesore janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme. Nga shqyrtimi i informacionit vihet re se llojet dhe niveli i tarifave edhe në këto vende ndryshojnë ndjeshëm nga njeri tjetri: p.sh. tarifa fikse fillestare për implementim kodit zgjidhje/parazgjedhje është afërsisht 500 mijë lek në Maqedoni, 27.5 mijë Euro në Mal të Zi, 50 mijë USD në Turqi dhe rreth 70 mijë Euro apo 100 mijë USD në Kroaci .

Tabela 2: Tarifat fikse me shumicë të Implementimit të Zgjedhjes/Parazgjedhjes së Bartesit në vendet e rajonit (Lek, pa TVSH): 2011

| | Kroacia | Maqedoni | Mali i Zi | Turqia |
|---|--|---|-------------------------|---------------------------|
| Implementimi i kodit të ZPB (pagese fikse vetem njëhere) | 10,000,000 | 499,030 | 3,767,500 | 5,000,000 |
| | Ose 219.000 Lek per central (ZB dhe ZPB) | Janë disa pagesa. Total 499. 030 lek one off (zgjidheje dhe parazgjedhje bartesi) | (27500 Euro) | (50000 USD) |
| Pagese në muaj | | 252.815 ne muaj | | |
| Implementimi i ZB | 73360 Lek x nr.centraleve+ 18340 Lekxnr.centraleve | | 753,500 (5,500 euro) | 2,000,000 (20,000 USD) |
| Pagesa per pajtimtar/kerkesë | 677 | 2,673 | 2,055 | |

Burimi: RIO e operatoreve inkumbent fikse ne vendet respektive

12. Nga analiza e informacionit të mësipërm dhe propozimit të Albtelecom, AKEP vlerëson se:

- Disa pagesa fikse janë të nevojshme për të kompensuar kostot e gjeneruara për operatorin e rrjetit (Albtelecom) të nevojshme për implementimin e ZB dhe të PB, si dhe kosto për administrimin e kërkesave;
- Vlerat e tarifave fikse me shumicë (midis operatorëve) të dhëna në tabelat e mësipërme tregojnë se ato kanë varianca të mëdha dhe tarifatat më të aplikuara janë tarifatat fikse për implementimin e Z(P)B në të gjitha centralet dhe tarifa për implementimin e PB për pajtimtar. Tarifa fikse për implementimin e Z(P)B në të gjitha centralet në vendet e rajonit variojnë nga rreth 3.8 milion Lek (27500 Euro) në Mal të Zi në 10 milion lek në Kroaci. Maqedonia aplikon vlerën më të ulët me rreth 500 mijë lek, por kjo është e shoqëruar edhe me një tarifë mujore që është 250 mijë lek/muaj (3 milion lek/vit).
- Zërat 1 dhe 5 aplikohen në të gjitha vendet e cituara më sipër dhe shpesh edhe me një tarifë. AKEP gjykon që zërat 1 dhe 5 të propozimit të Albtelecom të bashkohen dhe se vlera e kësaj tarife të jetë në nivelin 5 milion lekë, e shprehur si tarife implementimi për ZB dhe PB për të gjitha centralet e Albtelecom, duke eliminuar njëkohësisht zërat 2 dhe 3 të propozuara nga Albtelecom: tarifën mujore prej 278 mijë lek/muaj si dhe tarifën për çdo kërkesë (*aktivizimin/ndryshimin/anullimin/pezullimin*) për PB. Për zërin 4 të propozuar nga Albtelecom AKEP gjykon së pari që niveli i tarifës duket se është i lartë për kushte të tregut Shqiptar dhe një vlerë e arsyeshme do të ishte vlera 500 lek. Së dyti përshkrimi i shërbimit duhet të ndryshojë pasi kjo tarifë ka kuptim vetëm për PB dhe jo ZB. Pagesa extra për çdo thirrje për Z(P)B (zëri 6 i propozimit të Albtelecom) edhe për BT ka qënë i përkohshëm dhe nuk aplikohet më, prandaj AKEP gjykon që kjo tarifë ekstra për thirrjet të mos aplikohet, dhe për thirrjet e origjinuara për Z(P)B të aplikohen vetëm tarifatat përkatëse të origjinimit të thirrjeve.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë tarifat për implementimin e shërbimit të Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit, të depozituar nga Albtelecom sh.a me shkresën Nr.5444 Prot., datë 1.12.2012 (AKEP: Nr.1834 Prot., date 2.12.2012), duke imponuar ndryshimin e Pikës 9 të propozimit të Albtelecom si më poshtë:

1.5 Pagesat fikse te operatorit për Albtelecom në lidhje me Z(P)B

1. *Pagesë për implementimin dhe aktivizimin e prefiksit për Z(P)B e shprehur në tarifë për të gjitha centralet (paguhet vetem nje here):*

5,000,000 lek

2. *Tarifë për implementimin e PB për cdo linjë telefonike (kjo tarifë paguhet vetëm njëherë nga bartësi i thirrjeve për cdo pajtimtar)*

500 Lek/pajtimtar

2. Albtelecom sh.a. të përditësojë dokumentet përkatëse të publikuara në faqen e tij të Internetit, brenda një jave nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al
4. Albtelecom sh.a dhe palët e interesuara kanë të drejtë të bëjnë ankim administrativ, për këtë vendim, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURCE**